

MACROKOLOR SC

Bojë/veshje

FINITURA DEKORATIVE

Karakteristika

MACROCOLOR SC janë finitura minerale (bojë dhe veshje) me bazë gëlqere, dhe' ngjyrosëse, karbonat kalçiumi i mikronizuar, selice dhe shtesa bimore. Me të përfunduar punën, përbërje të tilla, duke reaguuar bashke me anhidritin karbonik të pranishëm në atmosferë me kripërat e kalçiumit të pranishme në suva, krijojnë një silicium koloidal dhe silikat kalçiumi, duke garantuar karakteristika të ngjeshjes optimale me suportin, përshkueshmëri të lartë nga avulli ujqor dhe qëndrueshmëri ndaj formimit të mykut në të njëjtën kohë. Të pigmentueshme në ngjyrat e kartelës, janë të përshtatshme për zbulurim dhe mbrojtje të sipërfaqeve të brendshme e të jashtme, duke na dhënë efekte estetike kromatike me vlerë.

Fusha e përdorimit

Për zbulurimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e sipërfaqeve minerale të brendshme dhe të jashtëme, megjithëse duke qenë më parë objekt trajtimi kundër lagështirës me suva të linjës MACROSAN. Të sugjeruara veçanërisht për finiturën dekorative të ndërtesave me interes historik dhe arkitektonik.

Avantazhe

- Jashtëzakonisht përthithëse (të përshtatshme si finiturë si cikle kundër lagështirës)
- Jashtë mase elastike
- Qëndrueshmëri optimale ndaj cënimeve të shkaktuara nga agjentët atmosferikë.
- Ngjeshje e fortë me suportin

Materialet e duhura

- Suva kundër lagështirës dhe lëmues përthithës
- Suva të parapërziera dhe tradicionale
- Llaç i përzier me bazë gëlqereje

Përgatitje e sipërfaqeve

Sipërfaqet duhen të jenë të staxhionuara të paktën tash 6 javë, të pastërta, të thata, pa copa që nuk janë kapur fort apo që mund të shpëputen. Heqje e bojërave të vjetra të bëra pluhur, e vajrave, e gjurmëve të objekteve të ndryshme si katrama apo çdo lloj materiali tjetër që s'ka të bëjë me muraturën. Përdor ECOFOND B500, me rul ose me brushë, mbi gjithë sipërfaqen e caktuar, të paktën 24 orë para shtrirjes së finiturës.

Mënyra e përdorimit

Finiturat MACROCOLOR SC më parë përzihen me kujdes, në mënyrë që cipa e mundshme e lëngut në sipërfaqe të shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme. Boja MACROCOLOR SC aplikohet me brushë ose me rul në dy duar që jepen tërthorazi në distancë të paktën 24 orë nga njëra-tjetra, duke e shkrirë të parën me 50% ujë, ndërsa të dytën me 20-30%. Veshja MACROCOLOR SC është gati për përdorim; ajo aplikohet me perdah inoksi në dy kalime dhe dora e lustrës i jepet me lëmues plastik.

Të dhënat teknike* dhe aplikuese**

	Bojë	Veshje
* Paketim	kovë 20kg	kovë 20kg
* Pamja	Pastë-bardh, ngjyra të kartelës Pastë-bardh, ngjyra të kartelës	
* Peshë specifike	1,45kg/l	1,67 kg/l
* Ekstrakt i thatë	55%	72%
* Thërrmim maksimal	0,2-07 mm	
* pH	12.5	13
* Shkrirja me ujë	dora e 1^ 50% gati për përdorim Dora e 2^ 30% gati për përdorim	
* Konsumi i mesëm	0.6 kg/m ²	2.5 kg/m ²
* Koha e përzierjes	5 min	5 min
* Kohë pritjeje mes dy duarve	24 orë	4-6 orë
* Përshkueshmëria nga avulli	$\mu < 15$	$\mu < 40$
* Temperaturë përdorimi	+5°C / +35°C	
* Kohë ruajtjeje:	6 muaj (në ambalazhim të plotë, mbajtur fresk, mbrojtur nga ngrirja)	
* Vegla	Brushë, rul, perdash inoksi ose plastik	

Paralajmërimë

- **Mos e përdor mbi sipërfaqe të ngrira, në fazë shkrirjeje apo që mund të ngrihet në 24 orët e ardhshme
- **Mos e përdor mbi mbajtëse të paqëndrueshme, të thërrmueshme e të pluhurta, nëse nuk janë përforcuar më parë
- ** Mos e përdor mbi sipërfaqe tepër të nxehta, ku ka shumë erë apo në pishë të diellit
- ** Mbro sipërfaqen e përdorur nga shiu intensiv 48 orët e para
- ** Mbro mermerët, xhamat, kasat e dritareve, ulluqet, strukturat e drunjëta etj gjatë përdorimit
- ** Produkti është alkaline, përdor mjetet e duhura për mbrojtjen e duarve dhe të syve.
- ** Laji me ujë veglat e përdorura menjëherë pas përdorimit

Vërejt! Vlera të tilla u referohen provave laboratorike në mjedis të kushtëzuar dhe mund të modifikohen ndjeshëm nga kushtet e vënies në përdorim.